

VENDIM
Nr. 350, datë 11.5.2016
PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË KRITEREVE TË KOMPENSIMIT TË
DËMIT TË SHKAKTUAR NDAJ PRONËS SË PUNONJËSIT TË POLICISË
USHTARAKE GJATË KRYERJES SË DETYRËS OSE PËR SHKAK TË SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake, për dëmin e shkaktuar ndaj pronës së tij gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, përfiton kompensim në lekë, në masën 100 për qind të vlerës së pronës së dëmtuar.

2. Kriteret për përfitimin e kompensimit janë si më poshtë vijon:

a) Të jetë shkaktuar dëm ndaj pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të punonjësit të Policisë Ushtarake;

b) Dëmi të jetë shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;

c) Pasuria, ndaj së cilës është shkaktuar dëmi, të jetë në pronësi ose bashkëpronësi të punonjësit të Policisë Ushtarake;

ç) Punonjësi të mos ketë përfituar dëmshpërblim për dëmin nga shoqëri sigurimi;

d) Kur vërtetohet se shkaktuesi i dëmit është dënuar në mungesë ose është shpallur i pamundur për të shlyer detyrimin civil, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Ministri i Mbrojtjes, për raste të dëmtimit të pronës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ngre një komision për vlerësimin e dëmit. Urdhri për ngritjen e komisionit i komunikohet menjëherë, në rrugë zyrtare, punonjësit të Policisë Ushtarake, prona e të cilit është dëmtuar.

4. Komisioni për vlerësimin e dëmit përbëhet nga 5 anëtarë, drejtohet nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka në përbërje, të paktën, një përfaqësues nga Policia Ushtarake.

5. Vendimi i komisionit të vlerësimit të dëmit bazohet në dokumentacionin që paraqitet nga vetë kërkuesi, si më poshtë vijon:

a) Vendimin e gjykatës ose të prokurorisë, në të cilën është përcaktuar shkak dhe vlera e dëmit në pasurinë e paluajtshme ose të luajtshme;

b) Vërtetimin e pronësisë, që punonjësi i Policisë Ushtarake është pronar ose bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të dëmtuar;

c) Vërtetimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që punonjësi nuk ka përfituar dëmshpërblim për dëmin nga shoqëri sigurimi.

6. Komisioni për vlerësimin e dëmit dhe hartimin e dokumentacionit merr vendim brenda 15 ditëve nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit nga punonjësi i Policisë Ushtarake.

7. Ministri i Mbrojtjes nxjerr urdhrin e dëmshpërblimit brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së vendimit të komisionit.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Vendimi nr. 163, datë 18.3.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe masën e kompensimit të dëmeve shkaktuar pronës së punonjësve të Policisë Ushtarake gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj", shfuqizohet.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama